



Njoftim për shtyp nr.14/539  
PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME  
25 Nëntor 2014

Fondi Monetar Ndërkombëtar  
Uashington, D. K. 20431 USA

### **Deklaratë në mbyllje të Misionit Shqyrtues të FMN-së në Shqipëri**

Njoftimet për shtyp në mbyllje të misioneve përfshijnë deklaratat e ekipeve të FMN-së ku jepen konstatimet paraprake pas vizitës në vend. Pikëpamjet e shprehura në këtë deklaratë janë të punonjësve të FMN-së dhe nuk përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e Bordit Ekzekutiv të FMN-së. Mbështetur në konstatimet paraprake të këtij misioni, stafi do të përgatisë një raport i cili, në varësi të aprovimit nga instancat drejtuese, do t'i paraqitet Bordit Ekzekutiv të FMN-së për diskutim dhe vendimmarrje.

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), nën drejtimin e zotit Nadeem Ilahi, vizitoi Tiranën gjatë periudhës 17-25 nëntor 2014, për të zhvilluar diskutime për shqyrtimin e dytë dhe të tretë të programi në kuadrin e Marrëveshjes së Fondit të Zgjeruar (EFF). Në fund të vizitës, zoti Ilahi mbajti këtë deklaratë:

“Programi ekonomik i Shqipërisë po ecën sipas planit. Ekipi i FMN-së arriti një marrëveshje në nivel stafi me autoritetet, për politikat që nevojiten për të përfunduar shqyrtimin e dytë dhe të tretë të EFF-së.

Shkalla e rritjes ekonomike parashikohet të jetë rreth 2 për qind këtë vit, e përforcuar nga rritja e fortë e eksporteve dhe e prodhimit të naftës, shlyerja e detyrimeve të prapambetura të shtetit në tregun e brendshëm dhe nga një rimëkëmbje modeste e kërkesës së brendshme. Por prodhimi vazhdon të jetë nën potencial dhe inflacioni pritet të mbetet i ulët.

Ecuria fiskale gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë të vitit 2014 ka qenë përgjithësisht në përputhje me objektivat e programit. Autoritetet vijojnë të mbeten të angazhuara për arritjen e objektivit të deficitit fiskal për vitin 2015, si edhe për t'i kufizuar shpenzimet brenda paketës së programuar. Pavarësisht shpenzimeve të konsiderueshme të lidhura me sektorin e energjisë elektrike, buxheti i vitit 2015 pritet të arrijë një zvogëlim të borxhit publik i shprehur si përqindje e PBB-së, për herë të parë që prej vitit 2010.

Pritshmëritë për inflacionin duket se janë të mbështetura mirë dhe politika monetare duhet të vazhdojë të mbështesë rimëkëmbjen ekonomike, në përputhje me mandatin e Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Rritja e kreditimit po rigjallërohet por

vazhdon të mbetet e ulët, e prekur nga niveli i lartë i kredive problematike dhe dobësitë në fushën e ekzekutimit të kontratave.

Nevojiten urgjentisht reforma në sektorin e energjisë elektrike, për t'i dhënë fund barrës fiskale të këtij sektori. Autoritetet kanë filluar të bëjnë hapat e parë të rëndësishëm në zbatimin e planit të tyre për reformimin e sektorit të energjisë elektrike, i hartuar në konsultim me Bankën Botërore. Ky plan përfshin kufizim të vjedhjeve të energjisë elektrike, propozime për të ristrukturuar tarifat brenda fundit të vitit 2014 (që do të zbatohet në tremujorin e parë të vitit 2015) dhe një reformë institucionale të ndërmarrjeve shtetërore që ushtrojnë aktivitet në këtë sektor. Staf i FMN-së e mirëpret planin për t'u dhënë kompensim shtresave të varfra përmes një kompensimi në të holla të përcaktuar mirë.

Misioni i stafit të FMN-së mbështet punën e autoriteteve për reformat strukturore dhe politikat dhe konsideron se kjo punë përbën bazën e besueshme për rimëkëmbjen e rritjes ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe financiar.

Bordi Ekzekutiv i FMN-së pritet të diskutojë për shqyrtimin e dytë dhe të tretë të EFF-së në fund të muajit janar 2015. Aprovimi i shqyrtimeve do të mundësonte lëvrimin e 47,1 milion SDR (rreth 53 milion euro). Programi 36-mujor në formë EFF-je për Shqipërinë është miratuar më 28 shkurt 2014 ([shih Njoftimin për shtyp nr.14/81](#)).”